



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKT LIGJ

Nr. ____/2026

**PËR PËRFSHIRJEN DHE AKSESUESHMËRINË E PERSONAVE ME AFTËSI TË
KUFIZUARA¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:
K R E U I**

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

1. Të garantojë aksesueshmërinë e mallrave dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet vendosjes së kritereve të aksesueshmërisë, duke eliminuar barrierat dhe parandaluar pengesat për gëzimin e të drejtave themelore nga personat me aftësi të kufizuara;

¹ Ky ligj është përafshuar tërësisht me Direktivën (BE) 2019/882 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14 prill 2019, “Mbi aksesueshmërinë e mallrave dhe shërbimeve”, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 151, datë 7.6.2019, faqe 70 – 115.

2. Të garantojë jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, duke rritur në maksimum autonominë e tyre dhe vendimmarrjen e pavarur, me synimin për të garantuar jetën në komunitet në kushte të barabarta me të tjerët.

Neni 2

Objekti

Objekti i këtij ligji është:

1. Të përcaktojë rregullat dhe detyrimet në lidhje me aksesueshmërinë e një kategorie të caktuar mallrash dhe shërbimesh që duhet të përmbushin kriteret e aksesueshmërisë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara me qëllim pjesëmarrjen e tyre të barabartë në shoqëri.
2. Përcaktimi i përgjegjësisë dhe kuadrit rregullator të të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore e vendore dhe operatorët ekonomikë, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë, përfshirë ato për mallra dhe shërbime të caktuara, për personat me aftësi të kufizuara duke siguruar konsultim të ngushtë dhe përfshirje të organizatave të shoqërisë civile për aftësinë e kufizuar, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. “Aftësi informatike interaktive” është çdo funksion që mbështet bashkëveprimin njeri-pajisje duke lejuar përpunimin dhe transmetimin e të dhënave, zërit, videos ose çdo kombinimi mes tyre.
2. “Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve.
3. “Autoritet kryesor përgjegjës” është institucioni shtetëror, strukturat në nivel qendror a vendor, i cili/të cilat, brenda fushës së veprimtarisë së tij/tyre, harton/jnë politika dhe ushtron/jnë përgjegjësitë në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.
4. “Biletë elektronike” është çdo sistem në të cilin e drejta për të udhëtuar, në formën e biletave të vetme ose të shumëfishta udhëtimi, abonetë e udhëtimit ose kreditit të udhëtimit, ruhet elektronikisht në një kartë fizike transporti ose në një pajisje tjetër, në vend që të shtypet në një biletë letre.
5. “Diskriminim i personave me aftësi të kufizuara” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose pasojë pengimin apo bërjen të pamundur të ushtrimit, njëlloj si të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura

nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

6. “Hedhje në treg” është bërja e disponueshme për herë të parë e një malli në treg.
7. “Importues” është çdo person fizik ose juridik i vendosur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë që hedh në treg një mall nga një vend i tretë.
8. “Komunikimet emergjente” janë ato komunikime të përkufizuara në legjislacionin e posaçëm në fuqi.
9. “Konsumator” është çdo individ që blen mallin përkatës ose është marrës i shërbimit për qëllime që janë jashtë tregtisë, biznesit, zanatit ose profesionit të tij.
10. “Lexues elektronik” është pajisje e dedikuar, duke përfshirë këtu harduerin edhe softuerin, që përdoren për të aksesuar, naviguar, lexuar dhe përdorur skedarët e librave elektronikë.
11. “Libër elektronik dhe softuer i dedikuar” është një shërbim, që përbëhet nga ofrimi i skedarëve digjitalë, që përcjellin një version elektronik të një libri, që përdoret, navigohet dhe lexohet. Këtu përfshihen dhe softuerët e pajisjeve mobile, si aplikacionet mobile të dedikuara, navigimi, leximi dhe përdorimi i skedarëve digjitalë, duke përjashtuar lexuesit elektronik.
12. “Mall” është çdo substancë, përgatitje ose mall joushqimor i prodhuar përmes një procesi prodhimi, me përjashtim të produkteve me origjinë njerëzore, ushqimore, bimore dhe shtazore dhe që lidhen drejtpërdrejtë me riprodhimin e tyre. Këtu përjashtohen mallrat që prodhohen nga mikrondërmarrjet.
13. “Mikrondërmarrje” është çdo ndërmarrje me më pak se 10 punëmarrës, e cila ka një xhiro vjetore që nuk tejkalon 2 milionë euro, ose një total bilanci vjetor që nuk tejkalon 2 milionë euro.
14. “Mjet ndihmës” është një pajisje ose një sistem produktesh që mund të modifikohet ose të përshtatet dhe të përdoret për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara për kapërcimin e pengesave dhe për të përmirësuar mundësitë e tyre për pjesëmarrje në mënyrë të barabartë.
15. “Mohim i përshtatjes së arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur mohohet ose kundërshtohet kryerja e rregullimeve ose ndryshimeve të domosdoshme dhe të përshtatshme që janë të nevojshme në një rast të veçantë, pa vendosur një barrë të tepruar, me qëllim garantimin që personat me aftësi të kufizuara të mund të gëzojnë dhe të ushtrojnë, në kushte të barabarta me të tjerët, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
16. “Ndërmarrje e vogël dhe e mesme” është çdo ndërmarrje që punëson më pak se 250 persona dhe që kanë një xhiro vjetore që nuk i kalon 50 milionë euro, ose një bilanci vjetor që nuk i kalon 43 milionë euro, por që nuk kategorizohet si mikrondërmarrje.
17. “Ndihmësi personal” është personi i zgjedhur, i udhëzuar dhe, sipas mënyrës së organizimit të shërbimit, i mbikëqyrur nga personi me aftësi të kufizuara për të ofruar asistencë personale, në përputhje me nevojat, zgjedhjet dhe preferencat e këtij të fundit.

18. “Ofrues shërbimi” në kuptim të këtij ligji është çdo individ ose person juridik publik dhe privat, i cili ofron një shërbim në treg, ose vetëofrohet për ta ofruar një shërbim për konsumatorët.
19. “Operator ekonomik” është prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar, importuesi, shpërndarësi ose ofruesi i shërbimit.
20. “Organizatë e personave me aftësi të kufizuara” është çdo organizatë jofitimprurëse, ku personat me aftësi të kufizuara kanë shumicën e cilësuar në vendimarrje.
21. “Organizatë për personat me aftësi të kufizuara” është çdo organizatë jofitimprurëse, që kryen veprimtari për personat me aftësi të kufizuara dhe/ose kryen aktivitete në mbrojtje të interesave të këtyre personave e të familjeve të tyre.
22. “Pajisje me aftësi llogaritëse interaktive që përdoret për të aksesuar shërbimet mediatike audiovizuale” është çdo pajisje qëllimi kryesor i së cilës është të ofrojë akses në shërbimet mediatike audiovizuale.
23. “Pengesat” nënkupton:
 - a) pengesat infrastrukturore dhe digjitale, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe sisteme informatike, mallra dhe shërbime publike e private;
 - b) pengesat, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar;
 - c) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.
 - d) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore.
24. “Persona me aftësi të kufizuara” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore, të cilat në ndëryprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.
25. “Përfaqësues i autorizuar” është çdo person fizik ose juridik që vepron brenda vendit, i cili ka marrë një mandat me shkrim nga një prodhues për të vepruar në emër të tij në lidhje me detyra të caktuara.
26. “Përfshirje” është pjesëmarrja efektive dhe e barabartë e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës, nëpërmjet heqjes së plotë të pengesave sociale mjedisore, infrastrukturore, digjitale dhe institucionale, të cilat shkaktojnë përjashtimin, izolimin ose veçimin e tyre dhe kufizojnë mundësitë e barabarta për këta persona.
27. “Përshtatje e arsyeshme” është modifikimi dhe rregullimet e nevojshme e të përshtatshme, që nuk vendosin një barrë joproporcionale ose të tepruar, kur ato nevojiten në një rast të caktuar, për t’u siguruar personave me aftësi të kufizuara gëzimin ose ushtrimin, në kushte të barabarta me të tjerët, të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.
28. “Pika e përgjigjes për sigurinë publike” janë ato shërbime të përkufizuara në legjislacionin e posaçëm në fuqi për sigurinë publike.
29. “Prodhues” është çdo person fizik ose juridik që prodhon një mall ose ka një mall të projektuar ose prodhuar, dhe e tregton atë nën emrin ose markën e tij tregtare.

30. “Shërbim” në kuptim të këtij ligji është çdo veprimtari ekonomike që vjen nga vetëpunësimi, që zakonisht kryhet kundrejt pagesës.
31. “Shërbim i biletave elektronike” është çdo sistem në të cilin blihen biletat e transportit të pasagjerëve, përfshirë ato online, duke përdorur një pajisje me aftësi ndërvepruese llogaritëse dhe i dorëzohen blerësit në formë elektronike, për të mundësuar që ato të shtypen në formë letre ose të shfaqen duke përdorur një pajisje mobile me aftësi ndërvepruese llogaritëse gjatë udhëtimit.
32. “Shërbim i plotë komunikimi” janë ato shërbime të përkufizuara në legjislacionin e posaçëm në fuqi për shërbimet e komunikimit elektronik.
33. “Shërbim i transportit rajonal” për qëllime të këtij akti përfshin vetëm transportin përmes hekurudhës, autobuzëve, metrosë, tramvajit dhe autobuz urban elektrik.
34. “Shërbim i tregëtisë elektronike” është ai shërbim që ofrohet në distancë, përmes faqeve të internetit dhe shërbimeve të bazuara në pajisje të lëvizshme, me anë të mjeteve elektronike dhe me kërkesë të një konsumatori me qëllim lidhjen e një kontrate konsumatore.
35. “Shërbime bankare për konsumatorin” është çdo shërbim bankar dhe financiar që përfshin:
 - a. marrëveshjet e kredive;
 - b. shërbimet sikurse përcaktohen në pikat 1,2,4 dhe 5 të Seksionit A dhe pikat 1,2,4 dhe 5 të Seksionit B të aneksit I të Direktivës 2014/65/BE;
 - c. shërbimet e pagesave sikurse përcaktohen në pikën 3 të nenit 4 të Direktivës 2015/2366/BE; d) shërbime të lidhura me llogaritë e pagueshme sikurse përcaktohen në pikë 6 neni 2 i Direktivës 2014/92/BE; dhe
 - d. paraja elektronike sikurse përcaktohet në pikën 2 të nenit 2 të Direktivës 2009/110/KE.
36. “Shërbime që sigurojnë qasje në shërbimet e mediave audiovizive” janë shërbimet e transmetuara përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike publike dhe private, që përdoren për të identifikuar, zgjedhur, marrë informacion dhe për të parë shërbimet e mediave audiovizive, përfshirë këtu çdo element të tyre të tilla si titrat për personat që nuk dëgjojnë ose me dëgjim të dobësuar, përshkrimi audio, guidat me programe elektronike, leximin e titrave dhe interpretimi në gjuhën e shenjave.
37. “Shërbimet e komunikimit elektronik” janë ato shërbime të përkufizuara në legjislacionin e posaçëm në fuqi për shërbimet e komunikimit elektronik.
38. “Shpërndarës” është çdo person fizik ose juridik në zinxhirin e furnizimit, përveç prodhuesit ose importuesit i cili e bën një mall të disponueshëm në treg.
39. “Sistem harduerësh kompjuterikë për qëllim të përdorimit konsumator” është kombinimi i harduerit që formon një kompjuter të plotë, i karakterizuar nga natyra e tij shumëfunktionale, aftësia e tij për të kryer detyrat më të zakonshme kompjuterike të kërkuara dhe që synojnë konsumatorin duke përfshirë kompjuterët personalë, në veçanti kompjuterët desktop, notebook-ët, telefonat inteligjentë dhe tabletët.
40. “Sistem operativ” quhet çdo program kompjuterik që menaxhon komunikimin me pajisjet periferike, organizon dhe shpërndan detyrat, siguron hapësirë për ruajtjen e të dhënave dhe

i ofron përdoruesit një ndërfaqe të paracaktuar kur nuk është aktiv asnjë aplikacion tjetër. Ky sistem përfshin edhe ndërfaqet grafike, pavarësisht nëse ato janë pjesë e integruar e harduerit të një kompjuteri me përdorim të përgjithshëm për konsumatorët, apo një program i veçantë. Në këtë përkufizim nuk përfshihen programet e nisjes së sistemit operativ, sistemi bazë input/output dhe mikroprogramet e tjera, që nevojiten vetëm gjatë nisjes ose instalimit të sistemit operativ.

41. “Specifikim teknik” është çdo specifikim që përmbush kërkesat e pikës 4 të nenit 2 të Rregullores (BE) nr. 1025/2012 dhe që ofron mjete për të përmbushur kriteret e aksesueshmërisë për mallrat ose shërbimet.
42. “Standard i harmonizuar” është çdo standard që përmbush përkufizimin e parashikuar nga pika 1(c) e nenit 2 të Rregullores (BE) nr. 1025/2012.
43. “Teknologji ndihmëse” është çdo artikull, pjesë pajisjeje, shërbim ose sistem mallrash, përfshirë softueret që përdoren për të rritur, mirëmbajtur, zëvendësuar ose përmirësuar aftësitë funksionale të personave me aftësi të kufizuara, ose për lehtësimin dhe kompensimin e dëmtimeve, kufizimet e aktivizimit, ose kufizimet e pjesëmarrjes aktive.
44. “Tekst në kohë reale” është një formë bisede me tekst ku komunikohet nga njëra pikë në tjetrën, ose përmes shumë pikave ku teksti që futet dërgohet në atë mënyrë, që komunikimi perceptohet nga përdoruesi si i vazhdueshëm.
45. “Terminal pagese” është çdo pajisje, qëllimi kryesor i së cilës është të lejojë kryerjen e pagesave duke përdorur instrumente pagese siç përcaktohet në pikën 14 të nenit 4 të Direktivës 2015/2366/BE në një pikë fizike shitjeje, por jo në një mjedis virtual.
46. “Tërheqje” është çdo masë që synon të parandalojë futjen e një malli nga zinxhiri i furnizimit në treg.
47. “Vendimmarrje e mbështetur” është ushtrimi i vullnetit nga një person me aftësi të kufizuara nëpërmjet një kompetence specifike të shtuar, që mbështet qëllimin dhe interesin e tij më të mirë, duke i mundësuar kryerjen e veprimeve për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime, kjo nuk përbën zëvendësim të vendimmarrjes dhe nuk cenon zotësinë për të vepruar të personit.

Neni 4

Parimet e përgjithshme

1. Parimi i mosdiskriminimit, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, për shkak të dëmitimit, përfshirë ndalimin e diskriminimit të shumëfishtë dhe refuzimit për të siguruar përshtatje të arsyeshme.
2. Parimi i barazisë, përfshirë barazinë gjinore, që siguron se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta.
3. Autonomia e personave me aftësi të kufizuara dhe respektimi i pavarësisë së vendimmarrjes

së personave me aftësi të kufizuara.

4. Garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimi të pengesave të të gjitha llojeve.
5. Përfshirja si mundësi e pjesëmarrjes efektive, nëpërmjet së cilës mundësohet pjesëmarrja e barabartë me të tjerët e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës.
6. Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet konsultimit individual dhe përfshirjes aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara.
7. Qasja në dy drejtime, për të integruar në maksimum të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në legjislacionin e zakonshëm dhe për t'i kufizuar në minimum çështjet që duhen trajtuar më vete.
8. Realizimi progresiv, sipas të cilit Qeveria ndërmerr masa progresive për të garantuar përfshirjen dhe aksesueshmërinë e të gjithë personave me aftësi të kufizuara në nivelin maksimal, që e lejojnë burimet e disponueshme, pa cenuar të drejtat e fituara, të cilat janë në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

KREU II

AKSESUESHMËRIA E MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE

Neni 5

Mallrat dhe shërbimet objekt i kërkesave të aksesueshmërisë

1. Fusha e zbatimit të këtij ligji përfshin mallrat e destinuara për përdorim konsumator që hidhen në treg dhe bëjnë pjesë në një nga këto kategori:
 - a) sistemet kompjuterike për përdorim të përgjithshëm dhe sistemet e tyre operative;
 - b) терминалет e vetëshërbimit, duke përfshirë терминалет e pagesës, bankomatët, makinat e shitjes së biletave, makinat e regjistrimit (check-in) dhe терминалет interaktive të informacionit, me përjashtim të atyre që janë pjesë përbërëse e automjeteve, avionëve, anijeve ose mjeteve të transportit hekurudhor;
 - c) pajisjet me aftësi ndërvepruese kompjuterike të përdorura për shërbimet e komunikimeve elektronike;
 - d) pajisjet me aftësi ndërvepruese kompjuterike të përdorura për akses në shërbimet e mediave audiovizive;
 - e) lexuesit elektronikë.
2. Fusha e zbatimit të këtij ligji përfshin shërbimet e destinuara për përdorim konsumator që hidhen në treg dhe bëjnë pjesë në një nga këto kategori:
 - a) shërbimet e komunikimeve elektronike, me përjashtim të shërbimeve të transmetimit që përdoren ekskluzivisht për komunikimin ndërmjet pajisjeve;
 - b) shërbimet që mundësojnë akses në shërbimet e mediave audiovizive;

- c) shërbimet për transportin e pasagjerëve përmes transportit ajror, rrugor, hekurudhor dhe ujor, në lidhje me faqet e internetit, aplikacionet celulare, biletat elektronike, shërbimet e biletimit elektronik, informacionin mbi udhëtimin, përfshirë informacionin në kohë reale, si dhe терминаlet interaktive të vetëshërbimit. Për shërbimet e transportit urban, periferik dhe rajonal, ky ligj zbatohet vetëm për терминаlet interaktive të vetëshërbimit;
 - d) shërbimet bankare për konsumatorët;
 - e) librat elektronikë dhe programet kompjuterike të dedikuara për përdorimin e tyre;
 - f) shërbimet e tregtisë elektronike.
3. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për komunikimet drejt numrit unik të emergjencës 112, në përputhje me legjislacionin në fuqi për komunikimet elektronike.
4. Kriteret e aksesueshmërisë për mallra dhe shërbime nuk zbatohen për:
- a) materialet audio dhe video të regjistruara paraprakisht dhe të publikuara përpara hyrjes së tij në fuqi;
 - b) dokumentet e publikuara në formate zyre përpara hyrjes së tij në fuqi;
 - c) hartat në internet dhe shërbimet e hartëzimit, në rastet kur informacioni thelbësor për navigimin sigurohet në një formë digjitale të aksesueshme;
 - d) përmbajtjen e krijuar nga palë të treta, e cila nuk financohet, nuk zhvillohet dhe nuk është nën kontrollin e operatorit ekonomik përgjegjës;
 - e) përmbajtjen e faqeve të internetit dhe të aplikacioneve celulare që kanë karakter arkivor dhe nuk është përditësuar ose redaktuar pas hyrjes së këtij ligji në fuqi.
5. Dispozitat e këtij ligji zbatohen pa cenuar kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi që rregullon aksesin në veprat e mbrojtura nga e drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura me të për personat që janë të verbër, kanë dëmtim të shikimit ose vështirësi të tjera në leximin e materialeve të shtypura.

Neni 6

Kriteret e aksesueshmërisë për mallrat

1. Mallrat e përcaktuar nga ky ligj hidhen në treg projektohen, dizajnohen dhe prodhohen në mënyrë të tillë që të maksimizojnë përdorimin e parashikueshëm nga personat me aftësi të kufizuara, në kushte të barabarta me të tjerët, sipas parimeve të dizajnit universal.
2. Mallrat e përcaktuar nga ky ligj përfshirë dhe shërbimet mbështetëse, paketimi dhe udhëzimet e përdorimit shoqërohen me elementët e aksesueshmërisë.
3. Mallrat e përcaktuar nga ky ligj përmbajnë elementë dhe funksione të cilat i lejojnë personat me aftësi të kufizuara të kenë akses, perceptojnë, veprojnë, kuptojnë dhe kontrollojnë mallin, që po përdorin.
4. Kriteret specifike të aksesueshmërisë së mallrave, procedurat dhe formatet miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave brenda tetëmbëshjetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 7

Kriteret e aksesueshmërisë për shërbimet

1. Me qëllim maksimizimin e përdorimit të parashikueshëm të shërbimeve nga personat me aftësi të kufizuara, shërbimet përmbajnë informacion mbi funksionet, praktikat, politikat dhe procedurat në lidhje me funksionet e shërbimit, i cili i drejtohet personave me aftësi të kufizuara.
2. Me qëllim maksimizimin e përdorimit të parashikueshëm të shërbimeve, ofruesit e këtyre shërbimeve sigurojnë:
 - a) aksesueshmërinë e mallrave që përdoren për të ofruar këto shërbime;
 - b) informacion mbi funksionet e shërbimit dhe lidhjen me mallra të tjerë në rast se nevojitet.
3. Kriteret specifike të aksesueshmërisë së shërbimeve, procedurat dhe formatet miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave brenda tetëmbëshjetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Nga këto kërkesa përjashtohen vetëm terminalët e vetëshërbimit.
4. Mjedisi i vënë në shërbim të klientëve për shërbimet e parashikuara nga ky ligj me qëllim maksimizimin e përdorimit të tyre nga personat me aftësi të kufizuara është në përputhje me kriteret e aksesueshmërisë të përcaktuara sipas pikës 2 të këtij neni.
5. Mikrondërmarrjet, që ofrojnë shërbime përjashtohen nga përmbushja e kërkesave të aksesueshmërisë.

Neni 8

Prezumimi i konformitetit për mallrat dhe shërbimet

1. Mallrat dhe shërbimet që janë në përputhje me standardet e harmonizuara ose me pjesë të tyre, referencat e të cilave janë botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, prezumohen se përmbushin kriteret e aksesueshmërisë të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 9

Detyrimet e prodhuesve të mallrave

1. Prodhuesit e mallrave sigurojnë përmbushjen e kërkesave të aksesueshmërisë në përputhje me këtë ligj për çdo mall që dizajnojnë dhe prodhojnë i cili është hedhur në treg.

2. Prodhuesit plotësojnë Deklaratën e Konformitetit EU dhe vendosin markimin CE pasi të vërtetojnë kryerjen e procedurës së vlerësimit të konformitetit dhe hartimin e dokumentacionit teknik në përputhje me kriteret e aksesueshmërisë.
3. Garantimi i detyrimeve sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni duhet të bëhet dhe për prodhimin në seri, duke përfshirë deklarin e çdo ndryshimi në dizejimin ose karakteristikat e mallrave.
4. Prodhuesit sigurohen që informacioni i kërkuar të jepet në paketim ose në një dokument që shoqëron mallrat e tyre, për të gjithë ato mallra që kanë një kod identifikimi, numër serial ose një element tjetër që lejon identifikimin e tyre.
5. Prodhuesit publikojnë në paketimin e mallit apo një dokument shoqërues të tij, emrin e tyre, emrin tregtar të regjistruar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën ku mund të kontaktohen. Adresa tregon një pikë të vetme ku mund të kontaktohet prodhuesi. Të dhënat e kontaktit vendosen në një gjuhë që kuptohet lehtësisht nga konsumatorët dhe autoritetet e mbikëqyrjes së tregut.
6. Prodhuesit sigurohen që malli të shoqërohet me udhëzime dhe informacione mbi sigurinë në një gjuhë që mund të kuptohet lehtësisht nga konsumatorët dhe përdoruesit e tjerë fundorë, siç përcaktohet nga legjislacioni përkatës për sigurinë e mallrave. Këto udhëzime dhe informacione, si dhe çdo etiketë janë të qarta dhe të kuptueshme.
7. Kur prodhuesit konstatojnë/vlerësojnë se malli i hedhur në treg nuk përmbush kriteret e aksesueshmërisë marrin masa korrigjuese, ose tërheqin mallin nga tregu.
8. Njoftimi i autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut për produktet joushqimore përbën detyrim ligjor. E gjithë procedura e aksesueshmërisë duhet të regjistrohet në një regjistër të posaçëm.
9. Dokumentacioni teknik i kërkuar sipas këtij ligji duhet të plotësohet, ruhet dhe vendoset në dispozicion të autoriteteve, me kërkesë të tyre, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e hedhjes së mallit në treg. Regjistri përmban detaje për mospërputhshmërinë dhe për çdo masë korrigjuese të marrë.
10. Prodhuesit që vlerësojnë se një mall i hedhur në treg nuk është në përputhje me këtë ligj marrin menjëherë masat korrigjuese të nevojshme për ta bërë mallin konform kërkesave të këtij ligji, ose nëse është e përshtatshme, ta tërheqin atë nga tregu.
11. Prodhuesit paraqesin autoriteteve të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të treguar konformitetin e mallit, në një gjuhë që mund të kuptohet lehtë nga autoriteti. Ata bashkëpunojnë me autoritetin e mbikëqyrjes për çdo veprim të ndërmarrë për të eliminuar mosrespektimin e kërkesave të zbatueshme të aksesueshmërisë së mallrave që prodhuesit kanë hedhur në treg, në veçanti duke garantuar përputhshmërinë e mallrave me kriteret e zbatueshme të aksesueshmërisë.
12. Prodhuesit i paraqesin autoritetit të mbikëqyrjes të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar përputhshmërinë e mallit me kriteret e aksesueshmërisë, në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për autoritetin. Ata bashkëpunojnë

me autoritetin e mbikëqyrjes për marrjen e masave të nevojshme për korrigjimin e çdo mospërputhjeje dhe garantimin e aksesueshmërisë së mallrave të hedhura në treg.

13. Kriteret që përmbushin prodhuesit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave brenda tetëmbëdhjetë muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Neni 10

Përfaqësuesit e autorizuar

1. Përfaqësuesit e autorizuar zbatojnë me përpikmëri të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në mandatin e përfaqësimit duke përfshirë:
 - a) mbajtjen e deklaratës së konformitetit EU dhe vënien e dokumentacionit përkatës në dispozicion të autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut;
 - b) vënien në dispozicion të autoriteteve të të gjithë informacionit dhe dokumentacionit përkatës që vërteton konformitetin e mallit;
 - c) bashkëpunimin me strukturat mbikëqyrëse të tregut për mallrat joushqimore, për të mënjeluar karakteristikat që pengojnë aksesueshmërinë e mallit.
2. Detyrimet specifike të përfaqësuesve të autorizuar për shpërndarjen e mallrave zbatohen në përputhje me legjislacionin e posaçëm në fuqi.

Neni 11

Detyrimet e subjekteve importuese

1. Importuesit hedhin në treg vetëm mallra që përmbushin kriteret e aksesueshmërisë në përputhje me këtë ligj. Ata sigurohen se procedura e konformitetit është kryer dhe dokumentuar sipas këtij ligji.
2. Kur importuesi dyshon se malli nuk përmbush kriteret e konformitetit, ai njofton prodhuesin dhe strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e mallrave joushqimore dhe nuk hedh mallin në treg deri në korrigjim të situatës.
3. Të dhënat tregtare identifikuese të importuesit përfshirë emrin, emrin tregtar ose markën e regjistruar, si dhe adresa ku importuesit mund të kontaktohen vendosen në mallin e importuar, paketimin ose në një dokument shoqërues në gjuhën e vendit ku po shitet malli. Mallrat shoqërohen me udhëzimet dhe informacionet e sigurisë përkatëse në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga konsumatorët dhe autoritetet e mikëqyrjes së tregut.
4. Importuesit sigurojnë dhe mbajnë përgjegjësi për moscenim të kriterëve të aksesueshmërisë gjatë magazinimit, ose transportit të mallrave.

5. Detyrimet për marrjen e masave korrigjuese ose tërheqjen e mallrave nga tregu, njoftimin e autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut, si dhe mbajtjen e dokumentacionit të konformitetit zbatohen në mënyrë të njëjtë si në rastin e prodhuesve.
6. Importuesit kanë të njëjtat detyrime me prodhuesit vetëm në ato raste kur malli që shpërndaj në treg del nën emrin ose markën e tyre të regjistruar, ose një mall tashmë i hedhur në treg është modifikuar në një mënyrë të tillë që mund të ndikohet përputhshmëria me kriteret e aksesueshmërisë.
7. Kriteret që përmbushin subjektet importuese të mallrave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave brenda tetëmbëdhjetë muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Neni 12

Detyrimet e distributorëve

1. Përpara se të shpërndaj në treg distributorët verifikojnë që malli mban shenjën CE, shoqërohet me dokumentet e kërkuara, me udhëzime dhe informacione sigurie dhe paraqitet në një gjuhë që mund të kuptohet lehtë nga konsumatorët.
2. Verifikimi i përmbushjes së kriterëve të aksesueshmërisë së mallit të ardhur nga prodhuesi kryhet përpara shpërndarjes së tij në treg.
3. Kur një distributor konsideron ose ka arsye të besojë se një mall nuk është në përputhje me kriteret e zbatueshme të aksesueshmërisë, malli nuk shpërndahet në treg derisa të jenë marrë masa korrigjuese dhe malli të jetë konform kriterëve të aksesueshmërisë. Në rast të kundërt malli tërhiqet nga tregu.
4. Kur malli nuk është në përputhje me kriteret e zbatueshme të aksesueshmërisë, distributori informon prodhuesin ose importuesin dhe autoritetet e mbikëqyrjes së tregut duke dhënë detaje mbi mospërputhshmërinë dhe për çdo masë korrigjuese të marrë.
5. Distributorët sigurohen, që kushtet e ruajtjes ose transportit nuk rrezikojnë përputhshmërinë e mallit me kriteret e aksesueshmërisë.
6. Distributorët vendosin në dispozicion të autoriteteve mbikëqyrëse të tregut të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, që tregon konformitetin e mallrave që shpërndahen prej tyre me kriteret e aksesueshmërisë. Ata bashkëpunojnë me autoritetin për çdo veprim të ndërmarrë për të eliminuar mospërputhshmërinë me këto kritere.
7. Distributorët kanë të njëjtat detyrime si përfaqësuesit e autorizuar në lidhje me kriteret formale ligjore që duhet të përmbushin mallrat përpara shpërndarjes në treg.
8. Distributorët kanë të njëjtat detyrime si prodhuesit vetëm në ato raste kur malli që shpërndaj në treg del nën emrin ose markën e tyre të regjistruar, ose një mall tashmë i hedhur në treg është modifikuar në një mënyrë të tillë që mund të ndikohet përputhshmëria me kriteret e aksesueshmërisë.

Neni 13

Identifikimi i operatorëve ekonomikë

1. Operatorët ekonomikë, me kërkesë të autoritetit të mbikëqyrjes së tregut për mallrat jo ushqimorë, identifikojnë:
 - a) operatorët ekonomikë që i kanë furnizuar me mallra;
 - b) operatorët ekonomikë të cilëve u kanë furnizuar mallra.
2. Informacioni identifikues për operatorët ekonomikë furnizues dhe të furnizuar është i disponueshëm për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga kryerja e furnizimit.

Neni 14

Detyrimet e ofruesve të shërbimeve

1. Ofruesit e shërbimeve sigurohen të dizenojnë dhe ofrojnë shërbime në përputhje me kriteret e aksesueshmërisë të parashikuara në këtë ligj.
2. Ofruesit e shërbimeve përgatisin të gjithë informacionin e nevojshëm dhe shpjegojnë në formë të shkruar dhe nëse është e nevojshme verbale, mënyrat se si shërbimet e tyre përmbushin këto kritere. Ky informacion vendoset në dispozicion të publikut në gjuhë të thjeshtë dhe të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara. Informacioni ruhet për atë kohë sa shërbimi vazhdon të ofrohet.
3. Ofruesit e shërbimeve sigurojnë zbatimin e procedurave të nevojshme për ruajtjen e përputhshmërisë së shërbimit me kriteret e aksesueshmërisë, duke marrë parasysh ndryshimet në karakteristikat e shërbimit, kriteret e aksesueshmërisë, standardet e harmonizuara dhe specifikimet teknike.
4. Në rastet kur shërbimi nuk është konform standardeve, ofruesit e shërbimeve marrin menjëherë të gjithë masat korrigjuese të nevojshme për të siguruar përputhshmërinë. Autoritetet mbikëqyrëse të shërbimeve sipas fushës së përgjegjësisë, informohen nga vetë ofruesit e shërbimeve mbi elementët, që nuk janë konform kërkesave ligjore të aksesueshmërisë.
5. Ofruesit e shërbimeve bashkëpunojnë me autoritetet mbikëqyrëse sipas fushës së kompetencës dhe vendosin në dispozicion të tyre, çdo informacion që vërteton plotësimin e kriterëve të aksesueshmërisë lidhur me shërbimin specifik.

Neni 15

Aksesueshmëria e shërbimeve të prokurimit publik

1. Kriteret e aksesueshmërisë të parashikuara nga ky ligj janë të detyrueshme dhe për shërbimet e prokurimit publik.
2. Çdo mall ose shërbim, karakteristikat, elementet ose funksionet e të cilit janë në përputhje me kriteret e aksesueshmërisë të përcaktuara nga ky ligj, prezumohet se përmbush edhe kriteret përkatëse të aksesueshmërisë të përcaktuara në legjislacionin sektorial në fuqi, për aq sa ato kanë të bëjnë me të njëjtat karakteristika, elemente ose funksione, përveç rasteve kur legjislacioni përkatës parashikon ndryshe.
3. Përputhshmëria me standardet e harmonizuara dhe specifikimet teknike ose pjesë të tyre, të cilat miratohen në përputhje me nenin 15, do të prezumohen se janë në përputhje me pikën 2 për aq kohë sa ato standarde dhe specifikime teknike ose pjesë të tyre plotësojnë kriteret e aksesueshmërisë të këtij ligji.

Neni 16

Ndryshimet thelbësore dhe barra joproporcionale

1. Kriteret e aksesueshmërisë të parashikuara në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji respektohen përveç rasteve kur:
 - a) këto kritere kërkojnë ndryshime thelbësore të mallit ose shërbimit sa që ndryshojnë natyrën e tij;
 - b) vendosin një barrë joproporcionale për operatorin ekonomik.
2. Parashikimet e pikës 1 të këtij neni nuk nënkuptojnë përjashtim të plotë nga detyrimet për të përmbushur kriteret e aksesueshmërisë. Vlerësimi i barrës jo proporcionale, duke përfshirë dhe barrën financiare kryhet në zbatim të udhëzimit të nxjerrë nga ministria përgjegjëse për ekonominë brenda tetëmbëdhjetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
3. Operatorët ekonomikë kanë detyrim të kryejnë një vlerësim të arsyetuar nëse përmbushja e kritereve të aksesueshmërisë sjell një ndryshim thelbësor, ose vendos një barrë financiare joproporcionale për mallin ose shërbimin që ata ofrojnë. Informacioni i përcillet autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut për mallrat joushqimore, ose autoriteteve të mbikëqyrjes së shërbimeve sipas fushës së kompetencës.
4. Operatorët ekonomikë kanë detyrimin të dokumentojnë vlerësimin e kryer sipas pikës 2 të këtij neni dhe të ruajnë këtë dokumentacion për 5 (pesë) vjet. Dokumentacioni i vihet në dispozicion autoriteteve të mbikëqyrjes së mallrave dhe shërbimeve, me kërkesë. Autoritetet kanë të drejtë të kërkojnë vetëm fakte të rëndësishme mbi vlerësimin.
5. Mikrondërmarrjet që prodhojnë mallra përjashtohen nga përgatitja e dokumentacionit vlerësues, përveç rasteve kur ky protokoll kërkohet nga autoritetet e mbikëqyrjes së tregut për produktet joushqimore .
6. Ofruesit e shërbimeve që vlerësojnë se përmbushja e kërkesave të aksesueshmërisë sjell një barrë joproporcionale përsërisin këtë vlerësim:
 - a) kur shërbimi pëson ndryshime thelbësore që tjetërsojnë natyrën e tij; ose

- b) kur autoriteti mbikëqyrës i shërbimeve ua paraqet këtë kërkesë për të shqyrtuar përputhshmërinë; ose
 - c) të paktën 1 (një) herë në çdo 5 (pesë) vjet.
7. Përfshirjet e parashikuara nga pika 1 e këtij neni nuk zbatohen kur operatorët ekonomikë përfitojnë financim nga fondet kombëtare ose ndërkombëtare për bërjen e mallrave dhe shërbimeve të aksesueshme.

Neni 17

Konformiteti i mallrave dhe markimi CE

1. Të gjitha deklaratat e konformitetit, parimet e përgjithshme dhe rregullat e posaçme të markimit CE parashikohen nga legjislacioni i posaçëm për mbikëqyrjen e tregut për mallrat joushqimore.
2. Përmbushja e kriterëve të aksesueshmërisë të parashikuara nga ky ligj duhet të jetë pjesë e deklaratës së konformitetit të BE-së dhe një kusht për vendosjen e markës CE.

Neni 18

Mbikëqyrja e mallrave joushqimore

1. Mbikëqyrja e tregut për mallrat joushqimore që përmbushin ose jo kriteret e aksesueshmërisë kryhet nga strukturat e mbikëqyrjes së tregut për mallrat joushqimore në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Në të gjitha rastet strukturat e mbikëqyrjes së tregut kontrollojnë:
 - a) kryerjen e procedurës vlerësimit në përputhje me kriteret e parashikuara nga neni 6 i këtij ligji;
 - b) rishikojnë konformitetin e vlerësimit dhe rezultatet e tij; dhe
 - c) përmbushjen e kriterëve të aksesueshmërisë në kuptim të këtij ligji.
3. Strukturat shtetërore që mbikëqyrin mallrat joushqimore sigurojnë vendosjen e informacionit të administruar në dispozicion të konsumatorëve, në të gjithë rastet kur u kërkohet, përveçse kur ky informacion përbën sekret sipas legjislacionit të posaçëm.

Neni 19

Procedura për mallrat jashtë kriterëve

1. Strukturat e mbikëqyrjes së tregut për mallrat joushqimore bëjnë inspektim mbi mallrat për të cilat ekziston dyshimi i arsyeshëm se nuk përmbushin kriteret e aksesueshmërisë të parashikuara në këtë ligj.

2. Operatorët ekonomikë kanë detyrim të marrin masa korrigjuese pa vonesa në rastet kur strukturat e mbikëqyrjes së tregut për mallrat joushqimore vlerësojnë se malli nuk përmbush kriteret e aksesueshmërisë. Ky detyrim zbatohet dhe për mallrat që qarkullojnë në tregun e Bashkimit Evropian.
3. Strukturat e mbikëqyrjes së tregut për mallrat joushqimore kanë të drejtë të ndalojnë përkohësisht qarkullimin e mallit që nuk përmbush kriteret e aksesueshmërisë, ose detyrojnë operatorët ekonomikë të tërheqin mallin nga tregu në rastet kur masat korrigjuese nuk merren brenda një afati të arsyeshëm.
4. Në rastet kur malli që nuk plotëson kriteret e aksesueshmërisë së parashikuara nga ky ligj, qarkullon edhe jashtë territorit shqiptar, strukturat e mbikëqyrjes së tregut për mallrat joushqimore njoftojnë Komisionin Evropian dhe autoritetet kompetente të çdo shteti anëtar të Bashkimit Evropian mbi përfundimet e inspektimit dhe masat korrigjuese të marra.
5. Komisioni Evropian dhe çdo shtet anëtar i BE-së njoftohen në çdo rast kur malli është ndaluar përkohësisht, ose është tërhequr nga tregu.
6. Informacioni i përcjellë përmban të dhënat e disponueshme në lidhje me identifikimin e mallit, orgjinën e tij, natyrën e kriterëve të aksesueshmërisë dhe mospërputhshmërisë, masat dhe kohëzgjatjen e masave që kanë marrë strukturat shqiptare të mbikëqyrjes së tregut për mallrat joushqimore shoqëruar me shpjegimet e paraqitura nga operatorët ekonomikë.
7. Strukturat përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut për mallrat joushqimore përcaktojnë nëse mungesa e përputhshmërisë vjen për shkak se:
 - a) malli nuk përmbush kriteret e aksesueshmërisë; apo
 - b) ekzistojnë mangësi në standardet e harmonizuara, ose në specifikimet teknike për të cilat prezumohet ekzistenca e konformitetit sipas nenit 8 të këtij ligji.
8. Shtetet anëtare të BE informojnë Komisionin Evropian për çdo masë të miratuar dhe për çdo informacion shtesë në dispozicion të tyre në lidhje me mospërputhshmërinë e mallit në fjalë, dhe për kundërshtimet e tyre në rast mosdakordësie me masën kombëtare të njoftuar.
9. Shtetet anëtare të BE sigurojnë marrjen e të gjithë masave për tërheqjen e mallit nga tregu i tyre në mënyrë të menjëhershme.

Neni 20

Mbikëqyrja e përputhshmërisë së shërbimeve

1. Mbikëqyrja e përputhshmërisë së shërbimeve me kriteret e aksesueshmërisë të përcaktuara në këtë ligj kryhet nga autoritetet përgjegjëse, sipas fushës së tyre të kompetencës.
2. Autoritetet përgjegjëse, sipas pikës 1 të këtij neni, në fushën përkatëse të kompetencës:
 - a) mbikëqyrin dhe verifikojnë në mënyrë periodike përputhshmërinë e shërbimeve me kriteret e aksesueshmërisë të përcaktuara në këtë ligj;

- b) shqyrtojnë dhe ndjekin ankesat dhe raportimet për shërbimet që pretendohet se nuk përmbushin kriteret e aksesueshmërisë;
 - c) kërkojnë nga ofruesit e shërbimeve informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për verifikimin e përputhshmërisë;
 - ç) kërkojnë marrjen e masave korrigjuese në rast të konstatimit të mospërputhshmërisë dhe përcaktojnë afatin për zbatimin e tyre;
 - d) verifikojnë marrjen dhe zbatimin e masave korrigjuese brenda afateve të përcaktuara;
 - dh) marrin masat administrative përkatëse, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin që rregullon sektorin përkatës.
3. Autoritetet përgjegjëse kryejnë mbikëqyrjen në mënyrë periodike, si dhe sa herë që marrin dijeni, nëpërmjet ankesave, raportimeve ose burimeve të tjera, për raste të mundshme të mospërputhshmërisë së shërbimeve me kriteret e aksesueshmërisë.
4. Kur një shërbim ose një rast mospërputhshmërie përfshin fushën e kompetencës së më shumë se një autoriteti, autoritetet përgjegjëse bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion për shqyrtimin e rastit dhe marrjen e masave përkatëse.
5. Autoritetet përgjegjëse bëjnë publike, në formate të aksesueshme, informacionin për veprimtarinë e mbikëqyrjes, rezultatet e saj dhe masat e marra për garantimin e përputhshmërisë së shërbimeve me kriteret e aksesueshmërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionin konfidencial.
6. Autoritetet përgjegjëse informojnë ofruesit e shërbimeve dhe publikun për kriteret e aksesueshmërisë që zbatohen në sektorin përkatës dhe ndërmarrin masa informuese dhe ndërgjegjësuese për zbatimin e tyre.
7. Rregullat e hollësishme për procedurat e mbikëqyrjes, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, masat korrigjuese dhe afatet për zbatimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave brenda tetëmbëdhjetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 21

Mosrespektimi formal i detyrimeve

1. Në rastet kur autoritetet mbikëqyrëse vërejnë mospërputhje të mallit apo shërbimit me kriteret e aksesueshmërisë, kërkojnë adresimin përkatës të mospërputhshmërisë lidhur me:
- a) shenja CE është vendosur në shkelje të nenit 30 të Rregullores (KE) Nr. 765/2008 ose të nenit 17 të këtij ligji;
 - b) shenja CE nuk është vendosur;
 - c) deklarata e konformitetit të BE-së nuk është hartuar;
 - d) deklarata e konformitetit të BE-së nuk është hartuar saktë;
 - e) dokumentacioni teknik nuk është i disponueshëm ose nuk është i plotë;
 - f) informacioni i përmendur në nenin 10(3) ose nenin 12(3) mungon, është i rremë ose i paplotë;

- g) çdo kërkesë tjetër administrative e parashikuar në neni 10 ose neni 12 nuk është përmbushur.
2. Kur mospërputhshmëria e përmendur në pikën 1 vazhdon, autoritetet shtetërore marrin të gjitha masat e duhura për të kufizuar ose ndaluar qarkullimin e mallit në treg, ose sigurohen për tërheqjen e tij nga tregu.

KREU III

AUTORITETET PËRGJEGJËSE, KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONET MBI AKSESUESHMËRINË

Neni 22

Përgjegjësitë e autoriteteve

1. Autoritetet kryesore përgjegjëse që ngarkohen për zbatimin e këtij ligji janë:
 - a) ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar;
 - b) ministria përgjegjëse për çështjet e ekonomisë dhe inovacionit;
 - c) ministria përgjegjëse për punët e brendshme; dhe
 - d) ministria përgjegjëse për çështjet e transportit dhe infrastrukturës.
2. Autoritetet kryesore përgjegjëse hartojnë dhe zbatojnë politikat për aksesueshmërinë, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, dhe koordinojnë veprimtarinë e institucioneve të tyre të varësisë për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji.
3. Autoritetet kryesore përgjegjëse bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion për zbatimin e këtij ligji kur mallrat ose shërbimet që nuk përputhen me kriteret e aksesueshmërisë, si dhe përfshijnë fushën e kompetencës së më shumë se një autoriteti.
4. Autoritetet përgjegjëse sigurojnë, sipas fushës së kompetencës, informimin e publikut dhe operatorëve ekonomikë për kriteret e aksesueshmërisë dhe masat e marra për zbatimin e tyre.
5. Bashkëpunimi me personat me aftësi të kufizuara dhe organizatat e tyre përfaqësuese sigurohet gjatë hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave dhe masave për aksesueshmërinë.

Neni 23

Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar

Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar:

- a) harton dhe koordinon politikat kombëtare për aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara;
- b) koordinon zbatimin e këtij ligji nga autoritetet kryesore përgjegjëse dhe institucionet e tjera publike;
- c) monitoron zbatimin e politikave dhe masave për aksesueshmërinë;
- ç) harton udhëzues dhe materiale orientuese për zbatimin e kërkesave të aksesueshmërisë;
- d) nxit bashkëpunimin ndërinstitutional dhe shkëmbimin e informacionit për çështjet e aksesueshmërisë;
- dh) siguron konsultimin dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese në hartimin dhe monitorimin e politikave të aksesueshmërisë;
- e) koordinon mbledhjen dhe raportimin e informacionit për zbatimin e këtij ligji;
- ë) propozon aktet nënligjore në fushën e saj të përgjegjësisë.

Neni 24

Ministria përgjegjëse për çështjet e ekonomisë dhe inovacionit

Ministria përgjegjëse për çështjet e ekonomisë dhe inovacionit:

- a) harton dhe zbaton politikat për aksesueshmërinë e mallrave dhe shërbimeve që lidhen me fushën e saj të përgjegjësisë;
- b) koordinon mbikëqyrjen e përmbushjes së kërkesave të aksesueshmërisë për mallrat që hidhen në treg;
- c) siguron, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, mbikëqyrjen e përputhshmërisë së mallrave me kriteret e aksesueshmërisë;
- ç) siguron mbikëqyrjen e përmbushjes së kërkesave të aksesueshmërisë për shërbimet në fushën e ekonomisë;
- d) harton metodologjinë për vlerësimin e barrës joproporcionale për operatorët ekonomikë;
- dh) koordinon masat për mbrojtjen e konsumatorëve në lidhje me aksesueshmërinë e mallrave dhe shërbimeve;
- e) bashkëpunon me autoritetet e tjera përgjegjëse për mbikëqyrjen e operatorëve ekonomikë dhe marrjen e masave korrigjuese;
- ë) informon dhe orienton operatorët ekonomikë, përfshirë mikrondërmarrjet, për përmbushjen e kërkesave të aksesueshmërisë
- f) propozon aktet nënligjore në fushën e përgjegjësisë së saj.

Neni 25

Ministria përgjegjëse për çështjet e transportit dhe infrastrukturës

Ministria përgjegjëse për çështjet e transportit dhe infrastrukturës:

- a) harton dhe zbaton politikat për aksesueshmërinë e shërbimeve të transportit të pasagjerëve;
- b) koordinon zbatimin e kërkesave të aksesueshmërisë në transportin ajror, rrugor, hekurudhor dhe ujor;
- c) siguron, nëpërmjet institucioneve përgjegjëse, mbikëqyrjen e përputhshmërisë së shërbimeve të transportit me kriteret e aksesueshmërisë;
- ç) koordinon zbatimin e kërkesave të aksesueshmërisë për faqet e internetit, aplikacionet celulare, biletat elektronike, shërbimet e biletimit elektronik, informacionin për udhëtimin dhe терминаlet interaktive të vetëshërbimit në sektorin e transportit;
- d) koordinon marrjen dhe monitorimin e masave korrigjuese nga operatorët e transportit;
- dh) nxit përfshirjen e kërkesave të aksesueshmërisë në politikat, standardet dhe investimet në infrastrukturën e transportit;
- e) propozon aktet nënligjore në fushën e përgjegjësisë së saj.

Neni 26

Ministria përgjegjëse për punët e brendshme

Ministria përgjegjëse për punët e brendshme:

- a) harton dhe koordinon politikat për garantimin e aksesueshmërisë së komunikimeve të emergjencës dhe përgjigjes ndaj tyre;
- b) siguron që komunikimet drejt numrit unik të emergjencës 112 dhe përgjigjja ndaj tyre të jenë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara;
- c) koordinon veprimtarinë e strukturave përgjegjëse për zbatimin dhe mbikëqyrjen e kërkesave të aksesueshmërisë në fushën e emergjencave;
- ç) siguron marrjen e masave për korrigjimin e rasteve të mospërputhshmërisë me kriteret e aksesueshmërisë;
- d) bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse për komunikimet elektronike për garantimin e aksesueshmërisë së komunikimeve të emergjencës;
- dh) propozon aktet nënligjore në fushën e përgjegjësisë së saj.

Neni 27

Banka e Shqipërisë

Banka e Shqipërisë, në përputhje me kompetencat e saj ligjore:

- a) mbikëqyr përputhshmërinë e shërbimeve bankare për konsumatorët me kriteret e aksesueshmërisë të përcaktuara në këtë ligj;
- b) kërkon nga ofruesit e shërbimeve bankare informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për verifikimin e përputhshmërisë;

- c) shqyrton ankesat dhe raportimet për mospërputhjen e shërbimeve bankare me kriteret e aksesueshmërisë;
- ç) kërkon marrjen e masave korrigjuese dhe verifikon zbatimin e tyre;
- d) merr masat administrative përkatëse, sipas këtij ligji dhe legjislacionit sektorial në fuqi.

Neni 28

Autoritetet rregullatore për komunikimet elektronike dhe median audiovizive

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive, sipas fushës së tyre të kompetencës:

- a) mbikëqyrin përputhshmërinë e shërbimeve përkatëse me kriteret e aksesueshmërisë;
- b) kërkojnë informacion dhe dokumentacion nga ofruesit e shërbimeve;
- c) shqyrtojnë ankesat dhe raportimet për mospërputhshmëri;
- ç) kërkojnë marrjen e masave korrigjuese dhe monitorojnë zbatimin e tyre;
- d) marrin masat administrative përkatëse në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin sektorial.

Neni 29

Sanksionet administrative dhe masat korrigjuese

1. Autoritetet mbikëqyrëse sipas fushës së përgjegjësisë vendosin sanksione administrative për shkeljet e kryera nga operatorët ekonomikë lidhur me kriteret e aksesueshmërisë së mallrave dhe shërbimeve.
2. Autoritetet mbikëqyrëse, sipas fushës së kompetencës, japin paralajmërim në inspektimin e parë ndaj operatorit ekonomik që nuk përmbush kriteret e aksesueshmërisë, kur mospërputhja është e korrigjueshme dhe nuk paraqet rrezik serioz, duke marrë parasysh shkallën e saj, numrin e mallrave ose shërbimeve të prekura dhe numrin e personave të prekur.
3. Paralajmërimi shoqërohet me urdhërimin për marrjen e masave korrigjuese dhe për eliminimin e pasojave të shkeljes, brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti mbikëqyrës. Ky afat nuk mund të jetë asnjëherë më shumë se nëntë muaj. Vendimi përfshin këshillimin me shkrim të operatorit ekonomik për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve dhe pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit.
4. Në rastet kur operatori ekonomik nuk ndërmerr masat e urdhëruara brenda afatit të caktuar nga autoriteti mbikëqyrës sipas pikës 3 të këtij neni, ky mosveprim përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë.

Neni 30

Klasifikimi i shkeljeve

1. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, klasifikohen në bazë të natyrës, rëndësisë, shtrirjes dhe pasojave të mospërputhshmërisë, në:
 - a) shkelje të lehta;
 - b) të rënda; dhe
 - c) shumë të rënda.
2. Në përcaktimin e kategorisë së shkeljes merren parasysh, në veçanti:
 - a) natyra dhe shkalla e mospërputhshmërisë me kriteret e aksesueshmërisë;
 - b) ndikimi i mospërputhshmërisë në mundësinë e personave me aftësi të kufizuara për të aksesuar dhe përdorur mallin ose shërbimin;
 - c) numri i mallrave ose shërbimeve të prekura nga mospërputhshmëria;
 - d) numri i personave të prekur ose që mund të preken nga mospërputhshmëria;
 - e) kohëzgjatja dhe shtrirja e mospërputhshmërisë;
 - f) përsëritja e shkeljes;
 - g) masat e marra nga operatori ekonomik për korrigjimin e mospërputhshmërisë dhe parandalimin e pasojave të saj;
 - h) zbatimi ose moszbatimi i masave korrigjuese të urdhëruara nga autoriteti përgjegjës;
 - i) shkalla e bashkëpunimit të operatorit ekonomik me autoritetin përgjegjës.
3. Konsiderohen shkelje të lehta mospërputhjet me karakter formal, procedural ose teknik, të cilat nuk pengojnë ose kufizojnë në mënyrë thelbësore aksesin dhe përdorimin e mallit ose shërbimit nga personat me aftësi të kufizuara dhe që mund të korrigjohen brenda një afati të arsyeshëm.
4. Konsiderohen shkelje të rënda mospërputhjet që pengojnë ose kufizojnë në mënyrë të konsiderueshme aksesin ose përdorimin e mallit ose shërbimit nga personat me aftësi të kufizuara, si dhe mosmarrja, brenda afatit të përcaktuar, e masave korrigjuese të kërkuara nga autoriteti përgjegjës.
5. Konsiderohen shkelje shumë të rënda mospërputhjet, që pengojnë në mënyrë thelbësore ose bëjnë të pamundur aksesin ose përdorimin e mallit ose shërbimit nga personat me aftësi të kufizuara dhe që, për shkak të shtrirjes, kohëzgjatjes, numrit të personave të prekur, përsëritjes së shkeljes ose moszbatimit të masave të urdhëruara nga autoriteti përgjegjës, sjellin pasoja të konsiderueshme për garantimin e aksesueshmërisë.

Neni 31

Masa e sanksionit

1. Shkelja nga operatori ekonomik e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj për garantimin e aksesueshmërisë së mallrave dhe shërbimeve përbën kundërvajtje administrative dhe

dënohet me gjobë deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë ose, në rastin e një shoqërie tregtare deri në 0.1% të xhiros totale vjetore të realizuar në vitin financiar paraardhës, cilado prej këtyre vlerave është më e lartë.

2. Në përcaktimin e masës së gjobës, autoriteti mbikëqyrës merr parasysh natyrën, rëndësinë, shtrirjen dhe kohëzgjatjen e shkeljes sipas kriterëve të parashikuara në nenin 30 të këtij ligji.
3. Gjoha e parashikuar në pikën 1 të këtij neni vendoset, sipas rastit, krahas masave korrigjuese të parashikuara në këtë ligj. Vendosja e gjobës nuk e përjashton operatorin ekonomik nga detyrimi për të marrë masat e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë e produktit ose shërbimit me kriteret e aksesueshmërisë.
4. Kur operatori ekonomik, pas konstatimit të mospërputhshmërisë, merr brenda afatit të përcaktuar masat e nevojshme korrigjuese dhe mospërputhshmëria nuk ka sjellë pasoja të konsiderueshme për aksesin ose përdorimin e produktit apo shërbimit nga personat me aftësi të kufizuara, kjo rrethanë merret parasysh në përcaktimin e masës së gjobës, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.
5. Masat administrative dhe gjobat sipas këtij neni vendosen nga autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e mallit ose shërbimit, sipas fushës së kompetencës së përcaktuar në këtë ligj.
6. Ankimimi i tyre kryhet në zbatim të parimeve të procesit administrativ parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
7. Rregullat nëse dhe në çfarë mase mund të vendosen sanksionet administrative të parashikuara në pikën 1 të këtij neni përcaktohen me një udhëzim të përbashkët miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet e aftësisë së kufizuar, ministri përgjegjës për ekonominë dhe inovacionin, ministri përgjegjës për punët e brendshme dhe ministri përgjegjës për transportin dhe infrastrukturën.

KREU IV JETESA E PAVARUR

Neni 32

Jetesa e pavarur

1. Jetesa e pavarur u garanton personave me aftësi të kufizuara të drejtën për të jetuar në komunitet me zgjedhje, kontroll dhe liri të barabarta me të tjerët, duke respektuar autonominë, vullnetin dhe preferencat e tyre individuale.
2. Politikat shtetërore mbështesin realizimin e së drejtës për jetesë të pavarur nëpërmjet krijimit të kushteve të nevojshme për pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës.
3. Në këtë kuadër, politikat shtetërore synojnë garantimin e aksesit efektiv në:
 - a) strehim të përshtatshëm dhe mundësinë për të jetuar ku dhe me kë të dëshirojnë;

- b) arsim gjithëpërfshirës dhe të kenë mundësi të zgjedhin institucionin arsimor në përputhje me legjislacionin arsimor në fuqi;
- c) një treg gjithëpërfshirës të punësimit;
- ç) qendra kulturore, sportive dhe qendra/hapësira të tjera publike;
- d) shërbime shoqërore;
- dh) qendra aftësimi dhe rehabilitimi;
- e) shërbime shëndetësore përmes infrastrukturës së përshtatshme;
- ë) transportin ajror, rrugor, hekurudhor dhe detar, duke përfshirë shërbimet e ofruara në faqet zyrtare të internetit, aplikacionet për pajisje mobile, biletat dhe shërbimet elektronike, marrja e informacionit mbi transportin në kohë reale, si dhe терминаlet e vetëshërbimit për pagesat;
- f) në komunikim dhe informacion përfshirë të gjithë llojet e komunikimit;
- g) në jetën politike dhe publike, si zgjedhës dhe të zgjedhur;
- gj) në aktivitete biznesi e sipërmarrjeje;
- h) në mallra dhe shërbime si:
 - pikat e pagesave;
 - bankomatet dhe pajisjet automatike të biletave;
 - терминаlet e pajisjeve specifike për konsumatorët që përdoren për komunikim elektronik dhe akses në shërbimet mediatike audiovizuale;
 - në shërbimet bankare për konsumatorin;
 - librat elektronikë dhe softuerët e dedikuar;
 - shërbimet e tregëtisë elektronike;
 - lexuesit elektronikë;
 - shërbimet e urgjencës me numrin “112”.

Neni 33

Shërbimet për një jetesë të pavarur

1. Jeta e pavarur mbështetet nëpërmjet shërbimeve të individualizuara që synojnë kapërcimin e barrierave dhe mundësojnë ushtrimin e zgjedhjes, kontrollit dhe pjesëmarrjes së plotë e efektive në komunitet.
2. Shërbimet për një jetesë të pavarur përfshijnë, ndër të tjera, asistencën personale, vendimmarrjen e mbështetur, pajisjet dhe mjetet teknike ndihmëse dhe forma të tjera të mbështetjes individuale.
3. Shërbimet për një jetesë të pavarur:
 - a) bazohen në nevojat, zgjedhjet dhe preferencat individuale të personit me aftësi të kufizuara;
 - b) sigurojnë kontrollin dhe pjesëmarrjen aktive të personit me aftësi të kufizuara në organizimin dhe ofrimin e shërbimit;

- c) mbështetin pjesëmarrjen në të gjitha sferat e jetës, përfshirë arsimin, punësimin, jetën sociale dhe komunitare;
- ç) ofrohen mbi bazën e procedurave të qarta dhe transparente.

Neni 34

Vendimmarrja e mbështetur

1. Çdo person me aftësi të kufizuara, që ka nevojë për ndihmë në vendimmarrje, merr mbështetjen e duhur nga një individ ose grup individësh të besuar. Mbështetja jepet gradualisht, duke u dhënë kohë të mjaftueshme personave që e kërkojnë atë, për të mësuar se si mund ta përdorin mbështetjen për më të mirën e tyre.
2. Rregullat, procedurat, kriteret e ofrimit dhe garancitë kundër ndikimit të padrejtë, mënyrat e dokumentimit, si dhe mekanizmat e ankimit dhe mbikëqyrjes për zbatimin e këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 35

Ndihmësi personal

1. Personi me aftësi të kufizuara ka të drejtë të zgjedhë, të udhëzojë dhe, sipas mënyrës së organizimit të shërbimit, të mbikëqyrë ndihmësin personal.
2. Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë, kur është e nevojshme, të përfitojnë trajnim për dhënien e udhëzimeve, orientimin dhe menaxhimin e asistencës personale, në përputhje me nevojat e tyre individuale.
3. Rregullat për organizimin dhe ofrimin e asistencës personale, përfshirë kriteret për përzgjedhjen e ndihmësit personal, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave brenda tetëmbëdhjetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 36

Mjetet ndihmëse

1. Mjetet ndihmëse u sigurohen personave me aftësi të kufizuara, që kanë nevojë për pajisje të tilla, me qëllim për të kapërcyer pengesat dhe rritjen e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri, bazuar kjo në vlerësimin e bërë nga komisioni, sipas pikës 1, të nenit 37, të këtij ligji.
2. Sigurimi, rimbursimi, riparimi/zëvendësimi dhe sipas rastit mirëmbajtja e mjeteve ndihmëse

financohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe koordinohet nga ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar.

KREU V

VLERËSIMI I AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE NEVOJAVE PËR MBËSHTETJE

Neni 37

Komisioni për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe nevojave për ndihmë e mbështetje

1. Vlerësimi i aftësisë së kufizuar realizohet nga komisionet multidisiplinare. Komisionet bëjnë vlerësimin e gjendjes së aftësisë së kufizuar, nevojave për shërbime, mjete ndihmëse dhe përkujdesje, me synimin për të minimizuar pengesat e përfshirjes dhe për të rritur autonominë dhe jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara.
2. Komisionet multidisiplinare për vlerësimin e aftësisë së kufizuar e të nevojave për ndihmë e mbështetje ngrihen dhe administrohen nga ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar.
3. Komisionet janë të pavarura në ushtrimin e funksioneve të tyre vlerësuese. Vlerësimi bëhet bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar për Funksionimin, Aftësitë e Kufizuara dhe Shëndetin (ICF) të Organizatës Botërore të Shëndetësisë duke marrë në konsideratë faktorët socialë.
4. Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar, nëpërmjet strukturave të saj, kryen:
 - a) kontrollin e zbatimit të rregullave dhe procedurave të veprimtarisë së komisionit;
 - b) bashkërendimin e punës me ministrinë përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë dhe mirëqënies sociale për të realizuar trajnimin e anëtarëve të komisioneve e të personelit mbështetës për metodat bashkëkohore të vlerësimit dhe për mjetet mbështetëse që disponohen.
5. Ngritja, administrimi, procedurat e vlerësimit, organizimi e funksionimi i komisionit dhe ankimet e vendimeve rregullohen me akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

Neni 38

Mbështetja financiare

1. Nevojat për asistencë dhe mbështetje, në kuptim të pikës 1, të nenit 37, të këtij ligji, mbështeten nga Buxheti i Shtetit. Planifikimi i fondeve të nevojshme për këtë qëllim është kompetencë e ministrisë përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar dhe bazohet në udhëzime dhe rekomandime të marra nga Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.
2. Institucionet shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, marrin gradualisht masat për sigurimin

e fondeve të nevojshme në përputhje me parimet e planifikimit buxhetor afatmesëm, për mënjanimin e pengesave mjedisore dhe infrastrukture në ofrimin e shërbimeve publike.

Neni 39

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar

1. Këshilli Kombëtar për Aftësinë e kufizuar është organ këshillimor që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar. Përbërja e tij miratohet mbi bazën e përfaqësimit të barabartë gjinor e gjithëpërfshirës.
2. Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar kryesohet nga ministri përgjegjës për çështjet e aftësisë së kufizuar dhe ka në përbërje:
 - a) zëvendësministrin e ministrisë përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar;
 - b) nga një përfaqësues të çdo ministrie, në nivel zëvendësministri;
 - c) Avokatin e Popullit;
 - d) Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
 - e) një përfaqësues të Institutit të Statistikave në nivel drejtues;
 - f) një përfaqësues të institucionit përgjegjës për sistemin e integruar të politikave në vend në nivel drejtues;
 - g) 7 anëtarë janë individë me aftësi të kufizuara, 5 përfaqësues të organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe 2 të organizatave për personat me aftësi të kufizuara
3. Sipas çështjeve që shqyrtohen, ministri përgjegjës për çështjet e aftësisë së kufizuar mund të ftojë në mbledhjet e Këshillit ekspertë të fushës, përfaqësues të organizatave të tjera të shoqërisë civile, institucioneve akademike, institucioneve të qeverisjes qendrore ose vendore, shoqatave të njësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe organizatave ndërkombëtare.
4. Për çështje me rëndësi të veçantë që lidhen me të drejtat, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar mund të zhvillojë mbledhje të përbashkëta me organe të tjera kolegjiale, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre.
5. Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar është 4 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që marrin pjesë në Këshill për shkak të detyrës. Ripërtëritja e të gjithë anëtarëve të Këshillit në të njëjtën kohë nuk lejohet.
6. Ministri përgjegjës për çështjet e aftësisë së kufizuar kujdeset për respektimin e kërkesave për përfaqësim të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.
7. Struktura përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar në ministrinë përgjegjëse ushtron funksionet e sekretariatit teknik të Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.
8. Rregullat e hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, procedurën e përzgjedhjes së përfaqësuesve të organizatave të

personave me aftësi të kufizuara dhe për aftësinë e kufizuar, zhvillimin e mbledhjeve dhe mënyrën e ushtrimit të funksioneve të sekretariatit teknik përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave brenda tetëmbëdhjetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 40

Detyrat e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar

Këshilli Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar ka këto detyra:

- a) këshillon Qeverinë për përcaktimin e drejtimit të politikave shtetërore për të garantuar aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat;
- b) i propozon ministrit që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, programet kryesore shtetërore për të garantuar aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat;
- c) vlerëson gjendjen konkrete të garantimit të aksesueshmërinë dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri, duke dhënë rekomandime të posaçme për ministrin që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar dhe autoritetet e tjera shtetërore, përgjegjëse në fushat përkatëse;
- ç) analizon zbatimin e politikave shtetërore dhe të programeve kombëtare e rajonale për aksesueshmërinë dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara;
- d) rekomandon shërbime dhe programe që janë specifikisht të orientuara për personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre;
- dh) shërben si organ konsultimi për çështjet që kanë të bëjnë me funksionimin e komisioneve për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe nevojave për ndihmë e mbështetje;
- e) bën propozime dhe jep rekomandime për përmirësimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara;
- ë) jep rekomandime për ndërtimin e mekanizmave të mbledhjes së statistikave, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe me institucionet e tjera shtetërore, si dhe mbikëqyr mbledhjen dhe përpunimin e tyre.

Neni 41

Bashkërendimi i veprimtarive për problemet e personave me aftësi të kufizuara

1. Institucionet shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me ministrin që mbulon çështjet e aftësisë së kufizuar, për shkëmbimin e informacionit dhe lehtësimin e përmbushjes së funksionit të tij. Për këtë qëllim, në çdo ministri, me urdhër të ministrit përkatës, njërit prej nëpunësve të ministrisë i ngarkohet ndjekja e çështjeve që lidhen me aftësinë e kufizuar. Organet e qeverisjes vendore emërojnë një ose disa nëpunës vendorë, që

merren me çështje të aftësisë së kufizuar, pranë tyre.

2. Nëpunësi që merret me çështjet e aftësisë së kufizuar është punonjësi i administratës publike, qendrore apo vendore, i cili ka formim dhe njohuri të posaçme në fushën e aftësisë së kufizuar dhe ka për detyrë të monitorojë që politikat e programet hartohen dhe zbatohen në përputhje me kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për aksesueshmërinë dhe përfshirjen, duke siguruar mundësi të barabarta me të tjerët për personat me aftësi të kufizuara.

Neni 42

Organizatat jofitimprurëse me të drejtë për t'u konsultuar

1. Institucionet publike, gjatë hartimit, rishikimit dhe zbatimit të politikave, legjislacionit dhe masave që lidhen me aftësinë e kufizuar ose ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtat dhe interesat e personave me aftësi të kufizuara, sigurojnë konsultimin e ngushtë dhe përfshirje aktive të:
 - a) individëve me aftësi të kufizuara;
 - b) organizatave të personave me aftësi të kufizuara;
 - c) organizatat për personat me aftësi të kufizuara;
 - ç) organizatat që përfaqësohen në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar.
2. Çdo organizatë jofitimprurëse, që pretendon se i është mohuar e drejta për t'u konsultuar apo se është përjashtuar pa të drejtë nga proceset konsultuese, ka të drejtë të ankohet, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin për njoftimin dhe konsultimin publik.

KREU VI MBËSHTETJA PËR ZBATIM

Neni 43

Të dhënat dhe statistikat

1. Instituti i Statistikave (INSTAT) në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse shtetërore për aftësinë e kufizuar mbledh, përpunon dhe publikon të dhëna të përshtatshme statistikore dhe kërkimore për aftësinë e kufizuar, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim mbështetjen e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave publike të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse.
2. Insitucionet shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, mbledhin dhe raportojnë të dhëna statistikore për aftësinë e kufizuar sipas fushave të përgjegjësisë së tyre. Llojshmëria, periodiciteti, metodologjia e mbledhjes së të dhënave dhe mënyra e raportimit të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 44

Imazhi publik dhe ndërgjegjësimi

1. Qeveria nxit një model bashkëkohor të aftësive të kufizuara dhe të dëmtimit, duke rritur ndërgjegjësimin për barazinë e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht duke theksuar mjetet për mbështetje dhe ndihmë për të siguruar mundësi dhe kushte të barabarta me të tjerët.
2. Media publike dhe private kontribuon dhe nxit promovimin dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara duke:
 - a) shmangur gjuhën, figurat ose përmbajtjet që nxisin stereotipe, paragjykime, trajtim tutelar ose diskriminim;
 - b) nxitur përfaqësimin real dhe vetëpërfaqësimin e personave me aftësi të kufizuara;
 - c) promovuar autonominë, jetesën e pavarur dhe pjesëmarrjen e plotë në komunitet, në kushte të barabarta me të tjerët.
3. Qeveria ndërmerr dhe mbështet fushata ndërgjegjëse për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe për përfshirjen e tyre në shoqëri në bashkëpunim me institucionet shtetërore në nivel qendror e vendor si dhe organizatat e shoqërisë civile.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 45

Aktet nënligjore

Brenda tetëmbëdhjetë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji:

- a) Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore në zbatim të neneve 6 pika 4; 7 pika 2; 9 pika 13; 11 pika 7; 20 pika 7; 34 pika 2; 35 pika 3; 39 pika 8 dhe 43 pika 3 të këtij ligji;
- b) Ministri përgjegjës për ekonominë dhe inovacionin miraton udhëzimin për metodologjinë e vlerësimit të barrës joproportionale në zbatim të nenit 16 pika 2 të këtij ligji;
- c) Ministritë përgjegjëse dhe autoritetet përgjegjëse, sipas fushës së kompetencës, nxjerrin aktet administrative të nevojshme për zbatimin e këtij ligji, në rastet kur kjo parashikohet nga legjislacioni sektorial ose nga aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

Neni 46

Shfuqizime

1. Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, shfuqizohet.

2. Aktet nënligjore në zbatim të ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, vazhdojnë të mbeten në fuqi deri në shfuqizimin e tyre nga aktet nënligjore, në zbatim të këtij ligji.

Neni 47

Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Niko PELESHI

Miratuar në datën _____